

Mbahet FIBA SCOD Klinika në Prishtinë

Më 4-5 Janar në organizim të Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe Departamentit të Gjyqtarëve të FIBA Europe është mbajtur FIBA SCOD Klinika në Prishtinë, në teori dhe praktikë. Në këtë Klinikë kanë ligjëruar FIBA Instruktori Nacional, Faton Kurshumlija, FIBA Instruktori, Gjorgji Piperkov dhe trajneri i mirënjohur, Arben Kransiqi. Klinikën e ndoqën 55 gjyqtarë. Gjyqtarët kanë realizuar video online testin, si dhe në pjesën e fundit të Klinikës të gjithë gjyqtarët e FBK-së të cilët janë pjesë e listës së Superligës i janë nënshtruar online testit nga njohja e rregullave të basketbollit. Qëllimi i organizimit të kësaj Klinike ishte përditësimi i rregullave të basketbollit për gjyqtarët e FBK-së.

Grumbullohen Përfaqësueset e reja të Kosovës

Gjatë muajit janar Përfaqësueset e Reja të Kosovës i kanë mbajtur grumbullimet e para në Prishtinë. Përfaqësueset e Kosovës gjatë verës do të marrin pjesë në FIBA Kampionate Evropiane. Kosova U20 (M) do të marrë pjesë në FIBA U20 Kampionatin Evropian, Divizioni B në Tbilisi të Gjeorgjisë prej 10 deri më 19 Korrik 2020; Kosova U18 (M) do të garojë në FIBA U18 Kampionatin Evropian, Divizioni B që do të mbahet në Oradea të Rumanisë prej 24 Korrik deri më 2 Gusht 2020; Kosova U16 (M) do të garojë në FIBA Kampionatin Evropian, Divizioni C në Prishtinë prej 11 deri më 19 Korrik 2020; Kosova U20 (F) do të marrë pjesë në FIBA U20 Kampionatin Evropian, Divizioni B në Ramat Gan të Izraelit prej 8 deri më 16 Gusht 2020; Kosova U16 (F) do të garojë në FIBA U16 Kampionatin Evropian, Divizioni B që do të organizohet prej 17 deri më 26 Korrik 2020 në Sarajevë të Bosnje e Hercegovinës.



Kosova 3x3 garon edhe këtë vit në kualifikimet e FIBA Europe Cup

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës ka marrë vendim që të mbështesë Përfaqësuesen e Kosovës 3x3, në garat ndërkombëtare edhe në vitin 2020. Kosova 3x3 vitin e kaluar kishte debutuar në kualifikimet e FIBA Europe Cup, ku ishte në grup me Slloveninë dhe Andorrën (1 humbje dhe 1 fitore). Pas debutimit historik, Përfaqësuesja e Kosovës 3x3 do të jetë pjesëmarrëse edhe në kualifikimet e FIBA Europe Cup për vitin 2020. Këto kualifikime do të mbahen në Konstanca të Rumanisë. Garat kualifikuese do të zhvillohen më 23-24 maj në Rumani.

FBK-ja prezanton logon për Kampionatin Evropian, Divizioni C për U16

Federata e Basketbollit e Kosovës më 10 Shkurt e ka prezantuar logon zyrtare të FIBA U16 Kampionatit Evropian, Divizioni C që do të mbahet në Prishtinë prej 11 deri më 19 korrik 2020. Ideja e logos është përgatitur nga FBK-ja, derisa është dizajnuar nga FIBA. Në logo është e pranishme harta e Kosovës me ngjyrat e topit të basketbollit dhe një lojtar në aksion, duke treguar për rëndësinë që ka ky Kampionat për Kosovën. Gjithashtu është cekur edhe vendi, Prishtina, ku do të mbahet kjo garë.



Spektakël në Rahovec, mbi 15 mijë shikues

Prej 11 deri më 15 Shkurt në palestrën "Mizahir Isma" në Rahovec është organizuar Final 8 Kupa e Kosovës në basketboll, në të cilën gjatë katër ditëve të pranishëm ishin rreth 15 mijë shikues.

Në Kupën e Ligës së Parë triumfoi Vëllaznimi, ku mundi AS Prishtinën me rezultat 72:66.

Në konkurrencën e femrave, triumfoi Bashkimi, që mundi në finale Mabetex Prishtinën 84:66. Saranda Daci, basketbolliste e KBF Bashkimi u zgjodh MVP.

Peja ka fituar Kupën e Kosovës në basketboll, duke mundur në finale Golden Eagle Yllin me rezultat 64:79. MVP u zgjodh Henrik Sirko, basketbollist i KB Pejës. KB Rahoveci edhe një herë u dëshmuar si organizator i shkëlqyeshëm, duke i kryer me përpikëri të gjitha detyrat bazuar në Udhëzuesin për Organizimin e Final 8 të Kupës së Kosovës dhe në kontratën e nënshkruar në mes FBK-së dhe KB Rahoveci.



Marmarinos: Nder të drejtoj Kosovën

Më 14 Shkurt para mediave është prezantuar përzgjedhësi i ri i Kosovës, Christos Marmarinos. "Fillimisht dua të them se kam hasur në një mikpritje të ngrohtë nga drejtuesit e FBK-së dhe po ndihem shumë mirë. Jam i nderuar që do të drejtoj Kosovën dhe do të kem mundësi të punoj me lojtarët e Kosovës. Për mua është një mundësi e mirë, por shpresoj se do të bëjmë një punë të mirë bashkërisht dhe do të kemi suksese. Synimi ynë të fitojmë. Kemi dy ndeshje të vështira, por ne do të përqendrohemi në forcat tona dhe lojtarët që kemi", ka thënë ndër të tjera Marmarinos.



Zyrtarët e lartë të FBK-së i presin ata të Islandës

Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu dhe Sekretarja e Përgjithshme, Elvira Dushku më 19 Shkurt në zyre të FBK-së pritën në një takim kryetarin e Federatës së Basketbollit të Islandës, Hannes Jonsson dhe Drejtorin e Përfaqësueses së Islandës, Kristinn Geir. Numri një i Federatës së Islandës, Jonsson e përgëzoi kryetarin e FBK-së, Arben Fetahu për punën që FBK-ja e ka bërë që nga pranimi në FIBA në vitin 2015, duke thënë se kjo punë është vërejtur dukshëm dhe është përmendur me zë të lartë në takimet e ndryshme të zyrtarëve të FIBA-s dhe FIBA Europe.

Dardanët e pamposhtur, mundin Islandën dhe Luksemburgun

Kosova e ka mundur Islandën me rezultat 80:78, në ndeshjen e parë në kuadër të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023. Takimi është zhvilluar më 20 Shkurt në palestrën e vogël në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Basketbollistët e Përfaqësueses së Kosovës kanë arritur që të gëzojnë rreth 3000 shikuesit e pranishëm në palestër, të cilët asnjëherë nuk rreshtën së përkrahuri ekipin tonë. Ndërkaq Kosova tri ditë më vonë është përballur me Luksemburgun si mysafire. Dardanët e kanë mposhtur edhe Luksemburgun në udhëtim me rezultat 80:84, në ndeshjen e dytë të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023. Te Kosova u dalluan Drilon Hajrizi me 25 pikë e shtatë kërcime, Erjon Kastrati me 19 pikë dhe Gëzim Morina me 13 sosh. Duhet theksuar se Kosova tani është e para në Grupin B me 4 pikë nga dy ndeshje të zhvilluara, e ndjekur nga Islanda me 3 pikë, aq sa ka edhe Sllovakia në vendin e tretë, kurse Luksemburgu ka 2 pikë me 2 humbje të regjistruara. Ndeshjet e radhës Kosova do t'i luajë në muajin nëntor si mysafire në Sllovaki dhe në Islandë.



Mbahet Kuvendi i Punës së FBK-së

Federata e Basketbollit e Kosovës më 29 Shkurt e ka mbajtur Kuvendin e Punës. Në këtë Kuvend, kryetari i FBK-së, Arben Fetahu dhe Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku kanë raportuar para delegatëve të pranishëm për punën e bërë gjatë vitit 2019 dhe për planet e vitit 2020.

Të pranishëm në Kuvendin e Punës ishin 38 delegatë nga 43 sa numëron gjithsej Kuvendi i FBK-së. Të gjitha pikat e rendit të ditës janë miratuar me shumicë votash.



Kosova mbetet në vendin e 69-të

Më 3 Mars, FIBA e ka publikuar renditjen më të re, ku Kosova edhe më tutje vazhdon të jetë në vendin e 69-të në botë. Dardanët në muajin shkurt fituan ndaj Islandës me rezultat 80:78 dhe Luksemburgut në udhëtim 80:84, megjithatë, nuk kanë lëvizur në renditjen më të re të publikuar nga shtëpia botërore e basketbollit. Sa i përket shteteve evropiane, Kosova ndodhet në vendin e 37-të, ashtu siç ishte në renditjen e kaluar.

Rugova pranohet në FIBA Time Out 2.0

Drejtori i Përfaqësuesve të Kosovës, Granit Rugova është pranuar në programin prestigjioz të FIBA-s të quajtur FIBA Time Out 2.0. Ky program është shumë i rëndësishëm dhe menaxhohet nga FIBA, derisa pjesë e saj do të jetë edhe Rugova, ndërsa në një fazë të mëvonshme këtij programi do t'i bashkëngjiten edhe Artina Hasani, menaxhere e zyrës së FBK-së dhe Edita Medunjanin, zyrtare administrative e FBK-së. Duhet theksuar se në këtë program në vitin 2018 pati diplomuar me sukses të shkëlqyeshëm Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku.

Mbahet aktiviteti “Her World, Her Rules” në Gjakovë

Federata e Basketbollit e Kosovës më 8 Mars në palestrën “Shani Nushi” në bashkëpunim me FIBA Evropën, UN Women Kosovo, Komunën e Gjakovës dhe KBF Vëllaznimin organizuan aktivitetin në basketboll për vajza të reja. Turneu është organizuar në kuadër të kampanjës së FIBA Europe Girls’ Program, “Her World, Her Rules”. Për tri orë janë organizuar shumë lojëra dhe kishte shumë befasi për të pranishmet e këtij aktiviteti, i cili është udhëhequr nga trajneri i KBF Bashkimit, Furkan Sagklik, ndërsa i kanë asistuar trajneri i KBF Vëllaznimi, Pal Sylja, si dhe basketbollistet, Saranda Daci, Jeta Zeka dhe Aisha Kaid.

“Her World, Her Rules” është një projekt unik dhe fushatë në mediat sociale, e udhëhequr nga FIBA Europe që ka për qëllim të promovojë basketbollin e femrave dhe vajzave nëpër Evropë nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme që realizohen në partneritet me Federatat Nacionale.



FBK-ja e vlerëson punën e gjithsecilit, nuk ka dallime gjinore

Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) e ka organizuar Forumin e parë për Gratë Lidere në Sport, i cili u mbajt në kuadër të festës së 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas në hotel “Sirius” në Prishtinë. Pjesëmarrëse ishte edhe ministrja për Kulturë, Rini e Sport, Vlora Dumoshi, si dhe dhjetëra femra lidere të federatave sportive në Kosovë, të Bordit Ekzekutiv të KOK-ut, trajnere, sportiste etj. Në këtë konferencë ishte e pranishme edhe Elvira Dushku, Sekretare e Përgjithshme e FBK-së, e cila ndër të tjera e theksoi faktin se në Federatën e Basketbollit të Kosovës nuk është me rëndësi se a je grua apo burrë, por vetëm a ke zotësi dhe a je e gatshme apo i gatshëm të marrësh përgjegjësi. Dushku një gjë të tillë e argumentoi edhe me fakte duke thënë se FBK do të duhej të ishte rol model për të gjitha organizatat tjera sportive në vendin tonë në të gjitha aspektet.



Shtyhet turneu i programit të FIBA Europe Youth Development Fund

Nga 13 deri më 16 Mars, në Prishtinë ishte paraparë të organizohet turneu në basketboll për Zhvillimin e Gjeneratave të Reja (YDF) të FIBA Evropës. Por, ky turne është shtyrë, për shkak të COVID – 19. Për shtyerjen e turneut FBK e kishte marrë edhe pëlqimin nga FIBA Europe dhe nga Federatat Nacionale pjesëmarrëse të turneut. Turneu në fjalë është pjesë e projektit të përbashkët të Federatave Nacionale, si Turqia, Kosova, Bullgaria, Rumania dhe Maqedonia Veriore. Projekti është pjesë e Programit për Zhvillim të Gjeneratave të Reja të FIBA Evropës (Youth Development Fund), ku pas suksesit dyvjeçar të këtij projekti të përbashkët, të 5 Federatat Nacionale e kanë vazhduar projektin, por vetëm me një ndryshim pozitiv, pasi që në edicionin 2018-2020 janë inkuadruar edhe vajzat U15.

Anulohet Klinika me trajnerin e njohur, Janez Drvaric

Më 15 Mars ishte paraparë të mbahej Klinika për Trajnerë në organizimin e Federatës së Basketbollit të Kosovës, FIBA Evropës dhe Shoqatës së Trajnerëve të Basketbollit të Kosovës. Ligjërues në këtë Klinikë ishte caktuar nga FIBA Europe, trajneri i njohur sloven, Janez Drvaric, megjithatë është anuluar për shkak të pandemisë COVID-19. Anulimi i kësaj klinike është bërë në koordinim me FIBA Evropën.

5 vjet pranim, 5 suksese në arenën ndërkombëtare

Më 13 Mars janë bërë 5 vjet, që kur Federata e Basketbollit e Kosovës u pranua në FIBA, duke thyer edhe barrierën e izolimit. Në këto vite nuk kanë munguar sukseset në arenën ndërkombëtare. Kosova U18 më 2018 shënoi një sukses të jashtëzakonshëm, duke u shpallur kampionin i Divizionit C në Evropianin U18, që u mbajt në Prishtinë. Sukses historik konsiderohet kalimi i Kosovës A në mesin e 32 Kombëtareve më të mira evropiane në kualifikimet për Kupën e Botës më 2017. Edhe pse një shtet i vogël, Kosova ka arritur për mrekulli të organizojë Kampionatin Evropian, Divizioni C U18. Ndodhi kjo më 2018, ku në fund Kosova zuri vendin e parë. Organizimi ishte për mrekulli. Kjo bëri që FIBA Evropa t'i besojë edhe organizimin e Kampionatit Evropian, Divizioni B për Femra U20. Liga Ballkanike (BIBL) ishte gara e parë ku klubet e meshkujve morën pjesë. Suksesi nuk mungoi, ku Sigal Prishtina më 2015 dhe 2016 u shpall kampione e kësaj lige. Prishtina ka regjistruar tjera suksese, ku në vitin 2019, hyri në mesin e 16 skuadrave më të mira në FIBA Europe Cup. Ndërkohë, te femrat, Mabetex Prishtina më 2020 mori pjesë në grupet e FIBA EuroCup Women

Pezullohen garat vendore për shkak të pandemisë COVID - 19

Federata e Basketbollit e Kosovës më 13 Mars duke iu referuar Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i ka njoftuar të gjithë anëtarët e saj, klubet e Superligës së Kosovës, Superligës së Femrave, Ligës së Parë të Meshkujve, Ligës së Parë të Femrave, Ligës së Dytë të Meshkujve dhe të gjitha klubet e ligave të kategorive të reja, se aktivitetet sportive, duke përfshirë këtu ndeshjet e basketbollit, janë pezulluar për shkak të pandemisë COVID – 19.

FIBA, donacion për FBK-në me pajisje sportive për lojën 3X3

Federata e Basketbollit e Kosovës më 17 Mars është njoftuar zyrtarisht nga FIBA se, kjo e fundit ka vendosur t'i jep FBK-së në formë donacioni pajisje sportive për lojën 3x3 duke përfshirë këtu terrenin e lojës 3x3 dhe semaforin për lojën 3x3. "Së fundi jemi njoftuar zyrtarisht nga FIBA se kjo e fundit ka vendosur të na dhurojë donacion një terren 3x3, semaforin 3x3 dhe topat 3x3. Kjo ndihmë vjen si rezultat i takimit që Kryetari i FBK-së, Arben Fetahu dhe unë e kemi pasur me Sekretarin e Përgjithshëm të FIBA-s, Andreas Zagklis dhe Drejtorin për Zhvillim, Zoran Radovic në fund të nëntorit të vitit të kaluar në Gjenevë. Në këtë takim, kryetari i FBK-së ka kërkuar nga Zagklis ndihmë në ndërtimin e konceptit të basketbollit 3x3 në Kosovë dhe masovizimin e lojës 3x3 ndër djem dhe vajza të reja, duke përfshirë këtu edhe ndihmën në terrene sportive".





Vazhdojnë përgatitjet për organizimin e FIBA U16 Kampionatit Evropian

Federata e Basketbollit e Kosovës është duke vazhduar me përgatitjet për FIBA U16 Kampionatin, Divizioni C sipas planit të paraparë në koordinim me FIBA Evropën. FIBA U16 Kampionati Evropian, Divizioni C është në program prej 11 deri më 19 Korrik 2020 në Prishtinë. Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, e cila njëherësh është edhe Udhëheqëse e Komitetit Lokal Organizativ të Kampionatit Evropian për faqen zyrtare të FBK-së ka bërë të ditura detajet rreth përgatitjeve për këtë event shumë të rëndësishëm, jo vetëm për basketbollin, por edhe për sportin kosovar në përgjithësi. “Pavarësisht situatës së krijuar me COVID-19, stafi i zyres ekzekutive të FBK-së kemi vazhduar punën nga shtëpitë dhe me intensitet të lartë në këto javë ne kemi punuar në përgatitjet për FIBA U16 Kampionatin Evropian, gjithnjë në koordinim me FIBA-n”. 11 shtete do të jenë pjesëmarrëse të FIBA U16 Kampionatit Evropian, Divizioni C e ato janë: Kosova, Shqipëria, Andorra, Armenia, Azerbajxhani, Malta, Moldavia, Skocia, Gjibraltari, San Marino dhe Uells.

Mesazhi i FBK-së: Mirëqenia e popullatës në përgjithësi dhe e komunitetit të basketbollit në veçanti, është dhe do të mbetet prioriteti ynë

Numri një i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu përmes një komunikate për media drejtuar opinionit ka bërë të ditur se institucioni që ai e udhëheq, është duke i përcjellë me vëmendje të shtuar të gjitha zhvillimet që ndërlidhen me pandeminë COVID-19. Dhe në të njëjtën kohë Fetahu ka kërkuar që të respektohen të gjitha këshillat e autoriteteve në vendin tone, që së bashku ta fitojmë edhe këtë betejë, e që kësaj radhe është me një armik më dinak dhe të padukshëm. “Mesazhi i Federatës së Basketbollit të Kosovës është i qartë: mirëqenia e popullatës në përgjithësi dhe e komunitetit të basketbollit në veçanti është, dhe do të mbetet prioriteti ynë gjatë kësaj periudhe të rëndë. Prandaj ju lutem kujdesuni dhe ndiqni këshillat e autoriteteve profesionale të vendit tonë që po e bëjnë të pamundurën për ta luftuar armikun global në këto ditë të rënda. Ndeshjet e basketbollit do të kthehen së shpejti, edhe atë më fuqishëm se kurdoherë më parë. Ndërkohë, ju lutem pranoni urimet e mia dhe të Federatës së Basketbollit të Kosovës për shëndet të mirë dhe tejkalim sa më të lehtë të kësaj situatë”.

Anulohen garat e Superligës së Meshkujve dhe të Femrave

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës duke i parë zhvillimet e fundit me pandeminë COVID-19, në bazë të kompetencave të veta statutare, më 31.03.2020 unanimisht ka marrë vendim që të anulohet garat në Superligën e Kosovës dhe Superligën e Femrave për edicionin 2019/20 dhe me këtë rast nuk do të shpallen kampionët e këtyre dy kompeticioneve. Bordi i FBK-së do të vazhdojë të përcjellë zhvillimet që ndërliken me pandeminë COVID-19 dhe gjatë muajit prill do të vendos për vazhdimin apo jo të garave të tjera në kuadër të FBK-së. Në lidhje me modalitetet e garave të tjera Federata e Basketbollit të Kosovës do të njoftojë opinionin me kohë pas konsultimeve në nivel vendor dhe ndërkombëtar. Bordi i FBK-së ka qenë i detyruar të marrë një vendim të tillë për shkak të përhapjes së pandemisë COVID – 19, ku numri i të infektuarve në vendin tonë ka përjetuar rritje të madhe në disa ditët e fundit. Për Bordin e FBK-së rëndësi ka shëndeti i basketbollistëve/eve, punëtorëve sportivë, shikuesve dhe të gjithë atyre që kontribuojnë në zhvillimin e garave të FBK-së.



Fetahu: Vendim i dhimbshëm, por i duhuri

Pas vendimit për anulimin e garave në Superligën e Meshkujve dhe në atë të Femrave, kryetari i Bordit të FBK-së, Arben Fetahu ka thënë se ky ka qenë vendimi më i dhimbshëm gjatë këtij mandate që është dashur ai t'ia paraqes Bordit. "Pas konsultimeve me të gjitha palët e interesit, dhe pas konstatimit se shëndeti i tifozëve, stafit dhe lojtarëve duhet të jetë prioritet i yni dhe në këtë frymë, Bordi i FBK-së ka vendosur njëzëri që të anulohet garat e edicionit 2019/20 në Superligën e Kosovës dhe Superligën e Femrave në basketboll. Për sportin tonë ky vendim është posaçërisht i dhimbshëm, duke qenë se u detyruam ta marrim atë në kulm të një edicioni garues me konkurrencë të fortë, me lojë të paparashikueshme në kuptim të rezultatit dhe në të cilin shikuesit e patën fjalën kryesore, gjë që dëshmohej me mbi 15.000 bileta të shitura gjatë javës së Final 8 të Kupës së Kosovës në Rahovec, me sallat e rimbushura plot anekënd Kosovës dhe me përcjelljen e interesin e shtuar mediatic ndaj sportit tonë të zemrës", ka thënë ndër të tjera numri një i FBK-së.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA